



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 9

Prishtinë, 09 qershor 2008, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media

Në mbledhje morën pjesë: Esat Brajshori, Fehmi Mujota, Shpresa Murati, Gani Buçinca, Ali Lajçi, Melihate Tërnikolli, Anita Morina, Synavere Rysha, Radmila Vujovic, ndërsa munguan: Hajdin Abazi dhe Rasim Selmanaj.

Të pranishëm: Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore, Fatime Qorri - zyrtare ligjore dhe Mirjeta Heta - nëpunëse administrative.

Mbledhjen e kryesoi z. Esat Brajshori, kryetar i Komisionit, që e propozoi këtë

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të KPM-së me plotësime shtesë;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të RTK-së;
4. Shqyrtimi i vërejtjeve të UNMIK-ut për Ligjin për statusin civil nr. 02/L-125;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur të Mediave me plotësime shtesë

Kryetari -Tha se Komisioni më 31 mars 2008 e ka shqyrtuar raportin vjetor të KPM-së dhe iu ka drejtuar KPM-së me konkluzione për plotësim të raportit. Më 20 maj Komisioni e ka pranuar plotësimin e Raportit vjetor dhe të gjitha pikat e kërkuara janë plotësuar.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës Komisioni e nxori këtë

R e k o m a n d i m

Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur të Mediave për vitin 2007 të radhitet për debat në seancë plenare.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryetari -Tha se Kuvendi e mori Raportin vjetor të RTK-së më 23. 05. 2008. Raporti u është shpërndarë të gjithë deputetëve. Sipas Ligjit për RTK-në, neni 33, RTK-ja i raporton Kuvendit në afate periodike dhe vjetore për llogarinë financiare. Raporti e përmban edhe një pjesë të strukturës organizative. Komisioni mund ta shqyrtojë si pjesë të fushëveprimit që e mbulon. Pjesën buxhetore të Raportit do ta shqyrtojë Komisioni për Buxhet dhe Financa. Hap diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Synavere Rysha - Tha se pjesa më e madhe e këtij raporti është përshkrim i punës. Pjesa financiare që është më e ndjeshme, është shumë pak e përfshirë në këtë raport. Nga ky raport shihet se RTK-ja e ka pasur një bilanc pozitiv dhe raporton se ka pasur suficit. Nëse RTK-ja nuk ka pasur nevojë për ato mjete, përse nuk i ka destinuar për ndonjë qëllim tjetër? Le të jetë ky një sugjerim për herët e tjera që mjetet e tepërta t'i kthejnë në llogari të Kuvendit ose në destinacione të tjera.

Gani Buçinca - Tha se ky raport është shumë sipërfaqësor, është më tepër i natyrës programore. Do të duhej të ishte shumë më i hollësishëm dhe më përmbajtësor. Kjo domethënë se nuk ka seriozitet të këtij institucioni për të raportuar për punën e vet dhe për t'i përmbushur detyrimet ligjore që i ka. Nga ky raport nuk shihet se është realizuar asnjë objektiv e këtij institucioni që është parashikuar me ligj. Nuk flitet asgjë për cilësinë e programeve që ofron RTK-ja, se si është bërë shpërndarja, orientimet – strategjia që duhet t'i prezantojë RTK-ja. Më se 10% e territorit të Kosovës nuk ka fare sinjal të RTK-së, edhe pse paguajnë për këtë medium. Nuk shihet se janë bërë përpjekje për ta zgjidhur këtë problem. Propozoj që Komisioni t'i rekomandojë Kuvendit të mos votohet ky raport dhe të kërkohet nga menaxhmenti i këtij institucioni një raport më i hollësishëm.

Shpresa Murati – Tha se Komisioni e ka marrë një përgjigje nga z. Zatriqi, pse RTK-ja nuk e ka kryer obligimin e mbulimit me sinjal në tërë territorin. Arsyetim sipas tij janë shkaqet financiare, pasi kërkohet një milion euro investim. Në anën tjetër qytetarët e paguajnë RTK-në edhe në territorin që nuk mbulohet me sinjal. Ne si anëtarë të Komisionit çka mund të bëjmë lidhur me këtë?

Anita Morina -Tha se raporti i RTK-së është shumë sipërfaqësor. Edhe pse për pjesën financiare të këtij raporti do të deklarohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, megjithatë ajo mendon se Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media është dashur të paktën ta ketë një raport për ndarjen buxhetore, për të hyrat, se si shpenzohen mjetet ose të dhëna për pagat e punëtorëve. Përveç problemit që RTK-ja nuk ka sinjal në gjithë Kosovën, ajo tha se me ligj është paraparë që familjet në asistencë sociale të lirohen nga parapagimi i RTK-së. Deri më sot ajo nuk e di as edhe një rast të vetëm që është liruar nga ky parapagim.

Ali Lajçi - Tha se ky raport nuk ka qasje përmbajtësore, prandaj si i tillë është i papranueshëm. Do të duhej një ndërrim i bordit dhe i drejtorit që e udhëheq këtë medium, për të pasur mundësi pastaj

për të diskutuar për një reformë të një institucioni kompakt me obligimet që i ka ky institucion në raport me qytetarët dhe publikun e tij.

Esat Brajshori - Tha se mangësia e këtij raporti është pasojë e mungesës së profilizimit të këtij mediumi. Ky televizion përpiqet të servojë shumë fusha dhe në asnjërën prej tyre nuk arrin të jetë në përmasat e profesionalizmit.

Pas diskutimeve të deputetëve për këtë pikë të rendit të ditës, Komisioni e nxori këtë

Rekomandim

Raporti i Radio Televizionit të Kosovës për vitin 2007 të radhitet për debat në seancë plenare.

4. Shqyrtimi i vërejtjeve të UNMIK-ut për Ligjin për statusin civil nr. 02/L-125

Esat Brajshori - I njoftoi anëtarët e Komisionit se Kuvendi i ka pranuar vërejtjet e UNMIK-ut për Ligjin për statusin civil L-02/125. Komisioni mund të formojë grup pune për shqyrtimin e këtyre vërejtjeve, por meqë pas 15 qershorit hyn në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ky ligj, si shumë ligje të tjera të panëshkruara, do të kalojë në kompetencë të institucioneve të Kosovës dhe do të procedohet sipas dispozitave kushtetuese. Hap diskutimin.

Fehmi Mujota - Tha se në kohën kur është shqyrtuar ky projektligj, për amendamentimin e tij, është bërë një punë e gjatë dhe e mundimshme. Për 74 amendamentet që i kishte ky projektligj, vërejtjet erdhën me një vonesë shumë të madhe. Sidoqoftë, ai tha se i vlerëson këto vërejtje, por kjo çështje do të rregullohet më mirë pas pesëmbëdhjetë qershorit.

Përfundim

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media nuk do të ndërhyjë në Ligjin për statusin civil nr. 02/L-125 para pesëmbëdhjetë qershorit 2008.

4. Të ndryshme

Esat Brajshori - Tha se në mbledhjen e kaluar të këtij Komisioni u vendos që Komisioni ta vizitojë Komunën e Prizrenit, por për shkak të seancës plenare të Kuvendit lidhur me ligjet e Pakos së Ahtisarit, nuk është realizuar kjo vizitë.

Fehmi Mujota - Propozoi që para shqyrtimit të Projektligjit për statistikat zyrtare t'i bëhet një vizitë Entit të Statistikës së Kosovës për të marrë informata të nevojshme, pastaj të fillohet me shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me propozimin e deputetit Fehmi Mujota Komisioni e nxori këtë:

Përfundim

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media do ta vizitojë Entin e Statistikës të Kosovës para se ta ketë filluar shqyrtimin e Projektligjit për statistikat zyrtare në Republikën e Kosovës.

Kryetari e shpalli mbledhjen të mbyllur në ora 13:50.

Përgatitur nga

Zyra Koordinuese e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Esat Brajshori